

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Shqiptarët sytë nga Haga, Albin Kurti i “frikësuar”?! Shton masat e sigurisë dhe i ngre gardhet para Krye ministrisë (E PLOTË)
ADRESA	https://newsbomb.al/rajon/shqiptaret-syte-nga-haga-albin-kurti-i-frikesuar-shton-masat-e-sigurise-dh-i401312
BURIMI	newsbomb.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 07:30:50 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 07:22:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	d2f526bdb750480d7ee0dd82d60c6b1334dc6a568d48f74e5e86886bd584aad3
TEKSTI	e1f4365d9e5552b940567b5336a962f4037d7c7553a1d3d0bc20132569a4731f
PAMJA	f0a16b76fef6e36bc756250f51ee495ad1f6ed7b53165c040a783c2a7c84efe8

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	1804f0d2eefa2a8e34611020f3e85f843ded30b79585aea183e77c5eb04bf1b4
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	41c8867184070196f446ef02a676766cc2aca397aa3ee03de1cf45e9c1c94b04
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahase hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/1804f0d2eefa2a8e34611020f3e85f843ded30b79585aea183e77c5eb04bf1b4>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

12 numrat e parë FALAS!
Version PDF

Abonohu te Revista

[Kreu](#)
[Politikë](#)
[Aktualitet](#)
[Ekonomi](#)
[Kulturë & Art](#)
[Rajon](#)
[Sport](#)
[Bota](#)
[Showbiz](#)
[SocialBomb](#)


Çështjet kryesore

Haga vendos sot për katër ish-krerët e UÇK-së!

Arrestohet Ergys Agasi

"Retreat"-i i qeverisë në Pogradec!

Rajoni

16 Shtator 2026, 09:22

Shqiptarët sytë nga Haga, Albin Kurti i "frikësuar"?! Shton masat e sigurisë dhe i ngre gardhet para Kryeministrit (E PLOTË)



Shkruar nga Newsbomb



Pamje nga Kryeministria-Albin Kurti

Kjo e mërkurë është dita që Kosova e ka pritur për vite. Sytë janë kthyer nga Haga, ku këtë të mërkurë pritet të shpallet aktgjykimi ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit.

Në Kosovë, por edhe jashtë saj, vëmendja është përqendruar te zhvillimet që priten në Dhomat e Specializuara. Qindra shqiptarë kanë udhëtuar drejt Hagës, ndërsa shumë prej tyre kanë kaluar natën pranë gjykatës.

Në një ditë të tillë, me vëmendjen e opinionit publik të përqendruar te verdikti që pritet të shpallet në Hagë, edhe në Prishtinë janë shtuar masat e sigurisë. Ambientet e Kryeministrit të Kosovës janë blinduar, ndërsa burime për mediat bëjnë me dije se janë rritur edhe masat e sigurisë për kryeministrin Albin Kurti.



Revista



Abonohu tani dhe lexoje >

Lajmet e fundit



Foto e Ditës

Shuhet në moshën 76-vjeçare
Flora Brovina

Aktualitet

Rama takohet sot me korçarët për
Territorialet, Rrugorja e Korçës
"aksion", nis pastrimi i perimetrit të
sigurisë

Zbulu më shumë artikuj >



Pamje nga Kosova, godian e qeverise e blinduar

Ndërkohë, tensionet nuk kanë munguar as në Hagë. Pak para nisjes së seancës, situata është tensionuar jashtë ambienteve të Dhomave të Specializuara, ku janë mbledhur qindra qytetarë shqiptarë për të pritur vendimin ndaj katër ish-krerëve të UÇK-së.

Policia holandeze u ka kërkuar disa herë protestuesve që të largohen nga hyrja e gjykatës dhe të zhvendosen në parkun ku autoritetet kanë lejuar zhvillimin e protestës.

Efektivët kanë paralajmëruar se nëse urdhri nuk do të zbatohej, do të ndërhyjnë për t'i larguar protestuesit.

Ky paralajmërim ka shkaktuar reagime të disa prej të pranishmëve, duke sjellë përplasje verbale me policinë holandeze. Pas paralajmërimit të tretë të policisë, situata është qetësuar dhe thirrjet ndaj efektivëve janë ndaluar.



Pamje nga Gjykata ne Hage

Në ato momente, Hysni Gucati, ish-kryetar i Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së, u është drejtuar protestuesve me një apel për qetësi.

"S'kemi punë me policinë holandeze", ka thënë Gucati, duke kërkuar nga të pranishmit që të shmangin çdo përplasje me autoritetet.

Ndërkohë që i pranishëm në Hagë është edhe ministri i Punëve të Jashtme, Glauk Konjufca, i cili ka deklaruar se ata presin sot pafajësinë e ish-krerëve të UÇK-së.

"Ne presim vetëm një vendim, aktgjykim lirues", është shprehur Konjufca.

"Sot është dita finale në këtë proces gjyqësor. Sot pritet një vendim, një aktgjykim lirues për katërshen drejtuese të Shtabit të UÇK-së. Lufta jonë ishte një luftë e domosdoshme mbrojtëse, kishte vetëm një qëllim, qëllimin e lirisë së popullit tonë dhe stopimin e gjenocidit të forcave paramilitare serbe", ka deklaruar ai ndër të tjerë.

Aktgjykimi pritet të shpallet në orën 10:00 në Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë. Seanca do të jetë publike dhe do të transmetohet në shqip, anglisht dhe serbisht, me një vonesë prej rreth 10 minutash.

Për Kosovën, kjo ditë vjen pas një procesi të gjatë. Katër ish-krerët e UÇK-së u arrestuan në nëntor të vitit 2020, ndërsa gjykimi ndaj tyre nisi në prill të vitit 2023.

Procesi ka zgjatur për më shumë se tre vjet, ndërsa në muajt e fundit palët kanë

paraqitur argumentet përfundimtare para trupit gjykues.

Një element i rëndësishëm i seancës së sotme është se aktgjykimi nuk do të jetë një vendim i vetëm për të katër të akuzuarit. Trupi gjykues do ta trajtojë veçmas çështjen për secilin prej tyre. Fillimisht pritet të lexohet vendimi për Hashim Thaçin, më pas për Kadri Veselin, Rexhep Selimin dhe në fund për Jakup Krasniqin.

Për secilin prej tyre do të shpallet verdikti për pikat përkatëse të aktakuzës, e cila përfshin akuza për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit.

Galeria fotografike ()



Sondazh

Poll

Lexo gjithashtu



🕒 E Mërkurë 09:29 Newsbomb

KUSH janë katër gjyqtarët që kanë në dorë fatin e katërshe të UÇK-së, të njëjtët do të marrin vendimin ndaj Thaçit për pengim drejtësie





Rajoni

Vendimi final për çlirimtarët e Kosovës, shqiptarë nga mbarë bota "zbarkojnë" para Gjykatës së Hagës, mbërrijnë dhe familjarët e katërshes

E Mërkurë 08:44 Newsbomb



Rajoni

Shqiptarët me sy e veshë nga Haga, vajza e Jakup Krasniqit emocionin me postimin, e bija puth portretin e gjyshit: Nuk jam e lirë pa lirinë tënde

E Mërkurë 08:02 Newsbomb



E Mërkurë 07:17 Newsbomb

Tre orë para momentit historik për katërshen e UÇK-së, qytetarët e gdhijnë në sheshin "Skënderbeu": Do jemi këtu deri në LIRI (PAMJE)



Rajoni

Prishtina në pritje të vendimit historik për ish-krerët e UÇK-së! Qytetarët mbushin sheshin "Skënderbeu", me flamuj në duar presin "ditën e re të lirisë"

E Martë 21:53



Rajoni

Kosova "sy e veshë" nga Haga nesër, spitali kryesor i Prishtinës merr masa

E Martë 20:34



E Martë 20:07

TRAGJEDI në Venecia! Aksidenti me varkë

u pret jeten ne mes çirrit te
sapomartuar, e reja shtatëzënë gjendet
pas tre ditësh në ujërat e ftohta



Rajoni

Sherri në borxhet "lau" me ai*k



Rajoni

Ditë historike në Kosovën! Givkata e

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.